




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Pranuar - Prilijeno Më/Dana 17.07.2012			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/862			

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 13.07.2012, merr

V E N D I M
PËR NDARJEN E NJË LOKACIONI PËR VENDOSJEN E NJË
CENTRALI TELEFONIK NË FSHATIN RADIVOJÇ

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë NDAN dhe cakton një lokacion në pasurinë e paluajtshme (tokën) pasuri shoqërore e Komunës së Vitisë e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr 313-2, lloji i pronës parcelë, zona u/r Unknown, vendi i quajtur "Radivojce Breg", me sipërfaqe prej 12m², Zona Kadastrale Radivojç, për vendosjen e (nyjës së qasjes) Centralit Telefonik, pronë e D.S Sela Radivojce SO Vitina, në fshatin Radivojç të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Ndarja e lokacionit për vendosjen e Centralit Telefonik në pasurinë e paluajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet duke u bazuar në kërkesën me nr. 07-16/218 të datës 16.02.2012 të Telekomit të Kosovës në Gjilan drejtuar Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Drejtorja për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë, obligohet që të bëjë ndarjen e njësive kadastrale për këtë lokacion.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorja për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Telekomit të Kosovës
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDI
Skenderbe Hebibi